



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.46/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj, kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Kosovski Savez, me seli në Leposaviq, e paraqitur kundër subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 28 dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 29.12.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa e subjektit politik Kosovski Savez, me seli në Leposaviq, ZP.Anr.46/2025, e datës 26.12.2025, kundër Subjektit Politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 28 dhjetor 2025.

II. Subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënim më gjorbë në lartësi prej 45,000.00 (katërdhjetë e pesë mijë) Euro.

III. Detyrohet Subjekti politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 26.12.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë të parashtruar nga Subjekti Politik Kosovski Savez, ku pretendohet më datë 25.12.2025, aktivistët e subjektit politik Kosovski Savez vunë re aktivistët e Listës Serbe në komunën e Leposaviqit, Zubin Potok dhe Graçanicë, duke ngjitur materialin e tyre promovues, duke shkelur kështu Udhëzimin Zgjedhor 7/2024 Materjalt janë vendosur në: stacion i autobusëve në Graçanicë, rruga për në Gjilan, fotot 1 dhe

2, Rr. Jelena Anzujska - komuna Zubin Potok, ndërtesa në pronësi të komunës Zubin Potok, foto 3, 4, 5, 6 dhe 7, Rruga Z.Potok - Mitrovicë, kioskë në tokë rrugore, foto 8, Rr. Krcuna Leposaviq, foto 9 dhe 10, Rr. Kosovskih Junaka - Leposaviq - foto 11 dhe 12, stacion autobusësh, rruga për në Mitrovicë, përballë Flotacionit, Trepçë, foto 13, 14 dhe 15, kryqëzimi i rrugëve Braçë Matoviç dhe Ivo Lola Ribar në Leshak, foto 16 dhe 17, stacion autobusësh Kamen, drejtim për në Mitrovicë, foto 18 dhe 19, stacion autobusësh Kamen, drejtim për në Jarinjë, foto 20 dhe 21, stacion autobusësh Jarinjë, drejtim për në Mitrovicë, foto 22 dhe 23, stacion autobusësh Jarinjë, drejtim për në Rashka, foto 24 dhe 25, stacion autobusësh Postenjë, drejtim për në Mitrovicë, foto 26 dhe 27, Separacija Leshak, foto 28, 29 dhe 30, Fshati Borova Leshak, foto 31 dhe 32, Rruga për në fshatin Drenovë dhe Gulijë, foto 33, 34, 35, 36 dhe 37, Rr. Karadjordjeva Leshak, foto 38 dhe 39, Rr. Kopaonicka Leshak, foto 40 dhe 41, Rruga Leshak - fshati Ostrace, foto 42, 43, 44 dhe 45, Rr. Gojko Baçanin Leshak, foto 46 dhe 47, Rr. Braçë Matoviç Leshak, përballë Shtëpisë së Kulturës në Leshak, foto 48 dhe 49, Rr. Braçë Matoviç Leshak, lokal në pronësi të Agjencisë për Privatizim, foto 50 dhe 51, Rr. Braçë Matoviç, Shtëpia e Shëndetësisë Leshak, foto 52, 53 dhe 54, Rr. Braçe Matoviç – Leshak, nënstation elektrik, fotografitë 55 dhe 56, Rr. Ivo Lola Ribar, Leshak, fotografitë 57, 58 dhe 59, Vendbanimi Tvrdan – Leposaviq, fotografitë 60, 61 dhe 62, Rr. 7 Korriku, Leposaviq, fotografitë 63, 64 dhe 65, Rr. 24 Nëntori, Leposaviq, fotografitë 66 dhe 67, Rr. 24 Nëntori, Leposaviq, kioskë në pronësi të Komunës së Leposaviqit, fotografitë 68 dhe 69, Rr. Vojvode Mišića, Leposaviq, fotografitë 70 dhe 71, Rr. Toplickih Ustanika, Leposaviq, fotografitë 72 dhe 73, Rr. Dositeja Obradovića, pranë rrugës për Shkollën e Mesme Ekonomike, fotografitë 74 dhe 75, Rr. Nemanjina, lokal në pronësi të Komunës së Leposaviqit, fotografitë 76 dhe 77, Shtëpia e Kulturës, Leposaviq – pronë e Komunës së Leposaviqit, fotografitë 78 dhe 79, Rr. Nemanjina, pranë Stacionit të Autobusëve në Leposaviq, fotografitë 80 dhe 81, Hyrja në Stacionin e Autobusëve në Leposaviq, fotografitë 82 dhe 83, Rr. Nemanjina, në afërsi të Stacionit të Autobusëve në Leposaviq, fotografia 84, Ndërtesa e Gjykatës në Leposaviq, fotografitë 85 dhe 86, Rr. Ushtrisë Jugosllave, kioskë në pronësi të Komunës së Leposaviqit, fotografitë 87 dhe 88, Qendra Sportive Soçanicë, fotografitë 89 dhe 90, Nënstation elektrik në fshatin Vuçë, fotografitë 91 dhe 92, Ndriçimi rrugor në fshatin Vuçë, pranë Kishës, fotografitë 93 dhe 94. Në ankesë ka paraqitur fotografi të materialit promovues - posterat në vendet në të cilat kanë qenë të vendosura ato.

Subjekti politik Lista Serbe, me datë 27.12.2025, ka paraqitur përgjigje në ankesë në të cilën ka theksuar se, në lidhje me ankesën e paraqitur Anr. 46-2025 më datë 26.12.2025, e cila i referohet vendosjes së përmendur të paligjshme të materialit promocional në vende ku kjo nuk lejohet, duam të theksojmë se i njëjti person ka paraqitur tashmë ankesë në lidhje me të njëjtën shkelje të rregullave, dhe se subjekti ynë politik është gjobitur me një gjobë monetare në shumën prej 20,000€, në bazë të ankesës Anr. 25-2025, si dhe sipas ankesës Anr. 32-2025. Në shtojcë ju dërgojmë materialet në të cilat shihet qartë se është bërë mashtrim, dhe se subjekti ynë politik i ka hequr materialet promocionale të përmendura, ndërsa ankesuesi ka shfrytëzuar foto të vjetra. Këto foto janë bërë në të njëjtat lokacione nga kënde të tjera, në territorin e komunës së Leposaviqit, dhe paraqitësi i ankesës është i vetëdijshëm për këtë. Prandaj, kjo është një çështje e vendosur tashmë dhe me të shkelet parimi *ne bis in idem*. Nga ana tjetër, ne si subjekt politik përgjegjës kemi ndërmarrë masa për heqjen e materialit të përmendur, prandaj

konsiderojmë se gjyqtarët e nderuar të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Paraqitje duhet të kenë parasysh se kjo është një insinuacion i qartë dhe i qëllimshëm me të cilin është keqpërdorur e drejta për ankesë, sepse është e qartë se ajo nuk është paraqitur në përputhje me Rregulloren Zgjedhore nr. 7/2024. Propozojnë që PZAP të pranojë përgjigjen ndaj ankesës si të bazuar, dhe që të hedhë poshtë ankesën e paraqitur nga subjekti politik Kosovski Savez.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës vlerësoi se:

-Ankesa është e bazuar.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndëve, përkatësisht ankesës ZP.Anr.46/2025, si dhe pas vlerësimit të provave të bashkëngjitura në ankesë dhe përgjigjes në të, PZAP-i, vlerëson se pretendimet e subjektit politik Kosovski Savez janë të bazuara.

Nga provat e parashtruara konstatohet se subjekti politik Lista Serbe ka vendosur materiale promovuese zgjedhore në disa hapësira publike, konkretisht: në: stacion i autobusëve në Graçanicë, rruga për në Gjilan, fotot 1 dhe 2, rr. Jelena Anzujska - komuna Zubin Potok, ndërtesa në pronësi të komunës Zubin Potok, foto 3, 4, 5, 6 dhe 7, Rruga Z.Potok - Mitrovicë, kioskë në tokë rrugore, foto 8, Rr. Krcuna Leposaviq, foto 9 dhe 10, Rr. Kosovskih Junaka - Leposaviq - foto 11 dhe 12, stacion autobusësh, rruga për në Mitrovicë, përballë Flotacionit, Trepçë, foto 13, 14 dhe 15, kryqëzimi i rrugëve Braçë Matoviç dhe Ivo Lola Ribar në Leshak, foto 16 dhe 17, stacion autobusësh Kamen, drejtim për në Mitrovicë, foto 18 dhe 19, stacion autobusësh Kamen, drejtim për në Jarinjë, foto 20 dhe 21, stacion autobusësh Jarinjë, drejtim për në Mitrovicë, foto 22 dhe 23, stacion autobusësh Jarinjë, drejtim për në Rashka, foto 24 dhe 25, stacion autobusësh Postenjë, drejtim për në Mitrovicë, foto 26 dhe 27, Separacija Leshak, foto 28, 29 dhe 30, Fshati Borova Leshak, foto 31 dhe 32, Rruga për në fshatin Drenovë dhe Gulijë, foto 33, 34, 35, 36 dhe 37, rr. Karadjordjeva Leshak, foto 38 dhe 39, Rr. Kopaonicka Leshak, foto 40 dhe 41, Rruga Leshak - fshati Ostrace, foto 42, 43, 44 dhe 45, rr. Gojko Baçanin Leshak, foto 46 dhe 47, rr. Braçë Matoviç Leshak, përballë Shtëpisë së Kulturës në Leshak, foto 48 dhe 49, Rr. Braçë Matoviç Leshak, lokal në pronësi të Agjencisë për Privatizim, foto 50 dhe 51, rr. Braçë Matoviç, Shtëpia e Shëndetësisë Leshak, foto 52, 53 dhe 54, Rr. Braçe Matoviç – Leshak, nënstacion elektrik, fotografitë 55 dhe 56, Rr. Ivo Lola Ribar, Leshak, fotografitë 57, 58 dhe 59, Vendbanimi Tvrdan – Leposaviq, fotografitë 60, 61 dhe 62, Rr. 7 Korriku, Leposaviq, fotografitë 63, 64 dhe 65, Rr. 24 Nëntori, Leposaviq, fotografitë 66 dhe 67, Rr. 24 Nëntori, Leposaviq, kioskë në pronësi të Komunës së Leposaviqit, fotografitë 68 dhe 69, Rr. Vojvode Mišića, Leposaviq, fotografitë 70 dhe 71, Rr. Toplickih Ustanika, Leposaviq, fotografitë 72 dhe 73, Rr. Dositeja Obradovića, pranë rrugës për Shkollën e Mesme Ekonomike, fotografitë 74 dhe 75, Rr. Nemanjina, lokal në pronësi të Komunës së Leposaviqit, fotografitë 76 dhe 77, Shtëpia e Kulturës, Leposaviq - pronë e Komunës së Leposaviqit, fotografitë 78 dhe 79, rr. Nemanjina, pranë Stacionit të Autobusëve në Leposaviq, fotografitë 80 dhe 81, Hyrja në Stacionin e Autobusëve në Leposaviq, fotografitë 82 dhe 83, rr. Nemanjina, në afërsi të Stacionit të Autobusëve në Leposaviq, fotografia 84, Ndërtesa e Gjykatës në Leposaviq, fotografitë 85 dhe 86, Rr. Ushtrisë Jugosllave, kioskë në pronësi të Komunës së

Leposaviqit, fotografitë 87 dhe 88, Qendra Sportive Soçanicë, fotografitë 89 dhe 90, Nënstacion elektrik në fshatin Vuçë, fotografitë 91 dhe 92, Ndriçimi rrugor në fshatin Vuçë, pranë Kishës, fotografitë 93 dhe 94.

Këto veprime përbëjnë shkelje nga ana e subjektit politik Lista Serbe, pasi materialet promovuese zgjedhore janë vendosur në hapësira publike, përfshirë shtylla elektrike, stacione autobusësh, vendbanime, fshatra, objekte publike, rrugë publike dhe sheshe publike. Rrjedhimisht, me këto veprime është shkelur neni 34, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i cili ndalon vendosjen e njoftimeve, pllakateve, posterëve, emrave ose sloganeve të fushatës zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike, në ose mbi rrugë publike, në shenja publike të trafikut, në hapësira të shfrytëzuara nga organizata ndërkombëtare, si dhe në hapësira private pa lejen e pronarit ose shfrytëzuesit.

Subjekti politik Lista Serbe ka qenë i njoftuar dhe i obliguar të veprojë në përputhje me pikën IV të Dispozitivit të vendimit ZP.Anr.25/225 të datës 22.12.2025 dhe me pikën IV të Dispozitivit të vendimit ZP.Anr.32/225 të datës 24.12.2025, me të cilat ishte urdhëruar që, nga momenti i pranimi të vendimeve përkatëse, të largohen të gjithë posterat dhe materialet zgjedhore nga hapësirat publike të përshkruara në ankesat e datave 19.12.2025 dhe ankesën e datës 23.12.2025; megjithatë, subjekti politik Lista Serbe ka larguar posterat dhe materjalin zgjedhor vetëm në Rr. Braçë Matoviç Leshak, përballë Shtëpisë së Kulturës në Leshak, foto 48 dhe 49, Rr. 24 Nëntori, Leposaviq, fotografitë 66 dhe 67, Rr. Vojvode Mišića, Leposaviq, fotografitë 70 dhe 71, Rr. Toplickih Ustanika, Leposaviq, fotografitë 72 dhe 73, Ndriçimi rrugor në fshatin Vuçë, pranë Kishës, fotografitë 93 dhe 94 ndërsa lidhur me materialet tjera zgjedhore nuk ka paraqitur asnjë provë apo dëshmi që do të vërtetonte se i është përmbajtur këtyre urdhrave, ndërsa nga provat e administruara në këto lëndë konstatohet se materialet promovuese zgjedhore kanë vazhduar të jenë të vendosura në hapësira publike edhe pas marrjes së këtyre vendimeve nga ana e PZAP-it, çka përbën moszbatim të drejtpërdrejtë të urdhrave të autoritetit kompetent.

Subjekti Politik Lista Serbe ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësitë gjatë procesit të fushatës zgjedhore, andaj vendosja e materialeve promovuese në fushatë zgjedhore pa lejen e organeve kompetente, përbën shkelje të legjislacionit zgjedhor, të cilat shkelje janë sanksionuar me dispozitat ligjore të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Në përgjigjen në ankesa, subjekti politik Lista Serbe ka pretenduar se parashtuesi i ankesës ka parashtruar fotografi që janë përdorur edhe në ankesat e mëparshme kundër këtij subjekti politik dhe se për këto raste tashmë janë shqiptuar gjopa, duke i konsideruar ato si çështje të gjykuara, si dhe ka deklaruar se ka ndërmarrë masa për largimin e materialeve të përmendura. Megjithatë, Paneli vlerëson se subjekti politik në fjalë ka kryer shkelje të rregullave zgjedhore të sipërcituara, pasi nuk ka vepruar në përputhje me vendimet e lartcekura dhe përkundrazi ka vazhduar me vendosjen e materialeve të tjera promovuese-zgjedhore të subjektit të tij politik edhe në vende tjera publike. Kjo rezulton edhe nga vetë përgjigja e

subjektit politik Lista Serbe, e cila nuk i mohon shkeljet e ndodhura dhe nuk shoqërohet me asnjë dëshmi konkrete që do të vërtetonte se të gjitha materialet e vendosura janë larguar nga vendet ku kanë qenë të vendosura.

Pretendimi se fotografitë janë përdorur edhe më parë është vlerësuar si pretendim i pa themeltë për faktin se nuk është mbështetur në prova konkrete, mirëpo një pretendim i tillë nuk e liron subjektin politik nga përgjegjësia për shkeljet e kryera përkundrazi, veprime të tilla përbëjnë bazë për sanksione shtesë, duke pasur parasysh se me vendimet e PZAP-it, ZP.Anr.25/225 të datës 22.12.2025, ZP.Anr.32/2025 të datës 24.12.2025 dhe ZP.Anr.37/225 të datës 26.12.2025, subjekti politik Lista Serbe ka qenë i obliguar të largojë posterat dhe materialet zgjedhore nga vendet ku ato kanë qenë të vendosura.

Pretendimi në përgjigje në ankesë se subjekti politik Lista Serbe ka marrë masa për heqjen e materialit të përmendur, është pretendim i pa bazuar, pasi që subjekti politik në fjalë ka larguar vetë disa materiale zgjedhore - posterat nga ku ishin të vendosura ato si ne vendet rr. Braçë Matoviç në Leshak, përballë Shtëpisë së Kulturës në Leshak, foto 48 dhe 49, Rr. 24 Nëntori, Leposaviq, fotografitë 66 dhe 67, Rr. Vojvode Mišića, Leposaviq, fotografitë 70 dhe 71, Rr. Toplickih Ustanika, Leposaviq, fotografitë 72 dhe 73, Ndriçimi rrugor në fshatin Vuçë, pranë Kishës, fotografitë 93 dhe 94 ndërsa për pjesën tjetër të posterave nuk ka dëshmuar asnjë përpjekje serioze për eliminimin e shkeljeve të konstatuara, në kuptim të nenit 120, paragrafi 2 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Duhet theksuar se ky vendim i PZAP-it, përfshin një numër të konsiderueshëm shkeljesh nga ana e të njëjtit subjekt politik, ndërsa lartësia e dënimit të shqiptuar është në përputhje me natyrën e shkeljes dhe praktikën e konsoliduar të ndjekur nga Paneli në raste të tilla. Me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit, ashtu siç është përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Paneli ka marrë parasysh të gjitha rrethanat relevante, përfshirë: natyrën e shkeljes dhe ndikimin e mundshëm të saj në procesin zgjedhor përkatës; shkallën dhe peshën e shkeljes; shkeljet e rregullave zgjedhore të kryera nga subjekti politik në këto zgjedhje, duke pasur parasysh faktin se i njëjti subjekt është sanksionuar edhe më parë gjatë kësaj fushate zgjedhore për shkelje të së njëjtës natyrë; përsëritjen e shkeljeve përmes veprimeve të njëpasnjëshme; si dhe moszbatimin e urdhrave të dhëna me vendimin e PZAP-it ZP.Anr.25/225 të datës 22.12.2025 dhe vendimin e PZAP-it ZP.Anr.32/225 të datës 24.12.2025, ZP.Anr.37/225 të datës 26.12.2025. Ndërsa si rrethanë lehtësuese Paneli ka marrë parasysh faktin se subjekti politik Lista Serbe ka larguar disa nga posterat ku kanë qenë të vendosura ato (në bazë të provave të ofruara paneli ka vlerësuar se subjekti politik Lista Serbe ka larguar materialin promovues - posterat në shtatë vende ku kanë qenë të vendosura).

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e palës ankuese janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, sepse shkelja ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod, me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të

tolerancës, demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit. Veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtuesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën siç është cek me lartë i pranoi si të bazuara. Andaj si përfundim, Paneli ka vlerësuar se veprimet e subjekti politik Lista Serbe janë në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe nenin 120 par 2 të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 2 të LZP-së, të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTESA

ZP.Anr.46/2025 më datën 29.12.2025

Kryesues i Panelit,

Arsim Hamzaj



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykata Supreme të Kosovës, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.